

VENDIM
Nr. 330, datë 27.10.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 95, DATË 9.5.2022, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL
TË PROKURORËVE”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenet 68 dhe vijues, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 159, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “c” dhe 190, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, “Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në aneksin nr. 7 “Metodologjia e pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit të Prokurorisë së Apelit” në pjesën I, paragrafi 4, “Kriteri aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, në nënkriterin C. Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesit në gerrat “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“b) Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun (10 pikë).

c) Publikimet ligjore akademike (5 pikë).”

2. Në vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, “Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në aneksin nr. 12 “Metodologjia e pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme”, në pjesën I, paragrafi 4, “Kriteri aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, në nënkriterin C. Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesit në gerrat “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“b) Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun (10 pikë).

c) Publikimet ligjore akademike (5 pikë).”

3. Këto ndryshime reflektohen në të gjithë tekstin e Metodologjisë aty ku është e zbatueshme.

4. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot, më 27.10.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani